

KONFERENCA E IX
VIOLENCA
NË SHËNDETIN MENDOR

LIBRI I ABSTRAKTEVE



8, 9 NËNTOR 2019
KORÇË, SHQIPËRI



Të nderua anëtarë të Lidhjes Psikiatrike Shqiptare dhe kolegë të tjerë, mirëse erdhët në Konferencën e 9-të të Lidhjes!

LPSH e filloi udhëtimin e vet që nga viti 2003, me idenë e formimit të një shoqate të përbashkët të psikiatërve shqiptarë, për herë të parë. Në Nëntor të vitit 2005 u mbajt në Strugë, Kuvendi i I-rë, ku u themelua “Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare”. Ka kaluar më shumë se një dekadë e gjysëm që atëherë, Lidhja vazhdon përpara udhëtimin e saj me konferencën e IX- të.

LPSH është sot shoqata kryesore mbarë kombëtare e profesionistëve të shëndetit mendor që përfaqëson psikiatrinë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Preshevë, Mali të Zi më gjërë.

Ne, ndihemi krenarë për rrugën në të cilën kemi ecur, përpjekjen e përbashkët për rritje profesionale. Ne e kemi çuar në një dimension tjetër bashkëpunimin tonë profesional dhe kujdesin ndaj pacientit. Aktivitetet e LPSH-së orientojnë profesionistët e shëndetit mendor të përmirësojnë qëndrimet e popullatës ndaj personave me probleme mendore, të minimizojnë faktorët e rrezikut dhe të orientojnë studimet shkencore për qasje të reja të kujdesit psikiatrik. Kontributi jonë profesional është një vlerë e shtuar e gjithë disiplinave të tjera në mjekësinë shqiptare.

Konferenca e IX-të me temë “Violenca në shëndetin mendor“, do të shqyrtojë dhe diskutojë çështje të rëndësishme të fushës që lidhen me volencën e cila ka një ndikim të ndërsjelltë në problemet e shëndetit mendor. Tema e përzgjedhur, është mjaft aktuale jo vetëm në hapësirat tona shqiptare por edhe më gjërë në botën e trazuar.

Shoqëritë tona kanë kaluar sfida të mëdha gjatë zhvillimit të tyre, luftra, konflikte, kriza politike dhe ekonomike, kanë përjetuar episode migrimi dhe emigrimi masiv, të cilat në tërësinë e tyre kanë provokuar ashpërsi dhe dhunë, duke influencuar mbi shëndetin mendor të popullatës. Një çështje tjetër e rëndësishme që prek gjithë shoqërinë tonë, është dhuna në familje e cila në mënyrë të veçantë prek gratë dhe fëmijët duke ndikuar direkt mbi shëndetin mendor të tyre.

Nga ana tjetër disa patologji psikiatrike, shoqërojnë simptoma me axhitim dhe pasoja të lidhura me psikozën, që kërkojnë një qasje profesionale në manaxhim.

Kjo konferencë, me kontributin e gjithësecilit nga JU, do të jetë një tryezë shkencore informimi dhe diskutimi cilësor, për të çuar më përpara prespektivat tona profesionale.

Përveç bashkëpunimit shkencor, takimet tona janë të rëndësishme dhe për të forcuar miqësinë mes njëri tjetrit, janë investim në njohjen më të mirë të trevave shqiptare dhe kulturës tonë.

Konferencën e fundit e bëmë në Strugë, simpoziumin në Krujë, dhe ky takimi i sotëm jo më kot vjen në qytetin e Korçës, si një nga qytetet e rëndësishme të Shqipërisë dhe një nga bashkitë më të mëdha të vendit .

Megjithëse Korça është themeluar në V-VI shekujt e fundit, zbulimet arkeologjike tregojnë jetë që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s. Tuma e Kamenices tregon banim që nga epoka e bakrit. Për Korçën flitet në vitet e mesjetes në shkrimet e Gjon Muzakes që përmbledh histori që nga viti 1280. Qyteti modern i Korçës filloi të ndërtohet në shekullin XV gjatë sundimit osman, nga Iliaz Bej Mirahori, xhamia e të cilit është ndër më të vjetrat në Ballkan. Sundimi osman mbi Korçën zgjati deri në 1912-tën, vit kur u shpall pavarësia e Shqipërisë.

Gjatë shekullit XIX-XX Korça u bë qendër e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare. Kështu u hap shkolla e parë fillore në gjuhë shqipe nga Organizata Drita, në Mars të vitit 1887, e më pas shkolla e parë për vajza nga motrat Qirjazi. Gjatë Luftës së Parë Botërore, qyteti ra nën kontrollin francez dhe në vitin 1917 u hap edhe Liceu Francez. Gjatë kësaj kohe u nënshkrua protokoli që shpallte Republikën Shqipëtare të Korçës, nën mbrojtjen ushtarake të ushtrisë franceze me president Themistokli Gërmënjin. Përfundimisht, Korça u bë pjesë e Shqipërisë në 1921. Qyteti ka shumë emra patriotesh si: Naum Veqilharxhi, Themistokli Gërmenji, Thimi Mitko, Papa Kristo Negovani, Mihal Grameno, etj. Në periudhën e Zogut, mbas Luftes II Botërore, Korça pësoi dy valë emigracioni për në komunitetin Shqiptaro - Amerikan në Boston.

Në vitet në vazhdim qyteti ka pasur uljet dhe ngritjet e veta, por gjithmonë ka qënë një influencë e rëndësishme në zhvillimin ekonomik të vendit. Korça përbën një nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë. Muzeumet e shumta në qytet përshkruajnë aktivitetin kulturor ndër shekuj: Mësonjëtorja-shkolla e parë shqipe, Muzeu arkeologjik, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar. Korça krenohet me piktorët: Vangjush Mijo, Andera Themel, Ruzhdi Goskova, e fotografjin Gjon Mili. Krenohet me artistët si Tefta Tasho Koço, me aktorët Thimi Filipi, Pandi Raidhi, Dhimitraq Orgocka, Stavri Shkurti, Jani Riza, Vangjush Furxhi, Violeta Manushi.

Korça njihet si një nga qytetet më romantike të Shqipërisë që është kthyer tashmë në një destinacion turistik.

Komisioni organizativ do të kujdeset për pritjen tuaj, dhe për t'i bërë sa më të këndshme dy ditët e qëndrimit në këtë qytet.

I uroj punë të mbarë dhe suksese kësaj Konferencë !

Anila Tasho Hashorva
Kryetare e LPSH

1. VIOLENCA NË PSIKIATRI Shkaqet dhe

Afrim Dangellia
IM of APA, DGPPN, SIP, AEP

Ne kemi Violencë në popullsinë e përgjithshme. Por është e vërtetë që Violenca shoqërohet me Çreg.mendore, por në një studim një vjeçar, ajo u gjet vetëm 4%. Kur 96 % e takojmë në popullsinë e përgj. Kështu, vetëm një përqindje e vogël e Violencës tek të sëmurët mendor na shfaqet.

Viktimizimi violent i të sëmurëve mendorë: Nga literatura rezulton se viktimizimi shfaqet: 7% – 56% e të sëmurëve mendorë: Moshë e re e të sëmurëve, abuzimi drogave (Një nga shkaqet më frekvente), të sëmurët e pastrehë. Por akoma thonë autorët nuk është e qartë: Në se violenca shkakton gjithnjë viktimizim apo vetë viktimizimi shkakton violence.

Prediktorët e violencës: Faktorët përcaktues të Violencës: Moshë e re e pacientit, Sexi mashkull, Abuzimi drogave apo alkolit, Pa kushte sociale, Simptomat pozitive tek i sëmuri, Një histori violence e kaluar, cilësohet si treguesi më kryesor për një violencë të re.

Mundësi trajtimi për Violencën: Dihet tashmë që psikotropët: Antipsikotikët, antipeileptikët, stabilizuesit e -- humorit, BZ ndikojnë ndjeshëm tek violenca. Por ka një medikament mbi të gjithë sipas NIMH (USA).

Sfidat e Research! Ka vështirësi të ndryshme për studimet e violencës në Psikiatri: Pacjentët violentë janë mjaft heterogjen, të paqëndrueshëm në studimet, stigma karshi tyre është e lartë, publiku ka mendime të ndryshme karshi këtyre pacientëve.(Studimi Austriak Univ.Innsbruck) Akoma nuk është i qartë kufiri ndërmjet Çreg. Mendore dhe violencës. Aq më tepër kur kemi të bëjmë me komorbidete siç i thamë më lart. Të përfshihen këta pacientë në studime paraqet pengesa të ndryshme për faktin se urgjenca e tyre e violencës kërkon intervenime të shpejta.
Çështja më e rëndësishme është, të ndahet sëmundja mendore nga rreziku që e shoqëron për violencën në syrin kritik të publikut.

Konkluzione: Mardhënia midis sëmundjeve mendore dhe violencës paraqet një çështje mjaft serioze dhe të koklaviutur në këndvështrimin e publikut (Social). Përderisa Neuroshkenca akoma dhe sot nuk përcakton shkaqet të sigurta që dëshmojnë për violencën, kjo bën që publiku të mbajë qëndrime të ndryshme karshi të sëmurëve mendorë. Ndikimi i psikotropëve tek *Violenca akoma kërkon studime të mëtejshme.* Studimi shkaqeve të veçanta që ndikojnë tek Violenca, do të duhet në të ardhmen të jetë në nivele më të larta.

Violence in Psychiatry Causes and

On Sunday afternoon, September 3, 2006, Wayne Fenton, a prominent schizophrenia expert and associate director at the National Institute of Mental Health (NIMH), was found dead in his office. He had just seen a 19-year-old patient with schizophrenia who later admitted to police that he had beaten Fenton with his fists.

"The WHO has defined violence as 'the intentional use of physical force or force, threatened or actual, against one's own, another person, or against a group or community, which either results in or has a high likelihood of resulting in injury, death,' psychological harm, mal-development or deprivation.

We have Violence in the general population. But it is true that Violence is associated with mental disorders, but in a one-year study, it was found only 4%. When 96% of the population is in the whole population. Thus, only a small percentage of Violence among the mentally ill appear to us. Violent victimization of the mentally ill: - The literature shows that victimization occurs: 7 - 56% of mentally ill: - The young age of the sick. Drug Abuse (One of the Frequent Causes) - The homeless people. But the authors still say it's not clear: Whether or not violence always causes victimization or victimization itself causes violent.

Predictors of Violence: Determinants of Violence: - The young age of the patient. - Male sex. - Drug or alcohol abuse. - No social conditions. - Positive symptoms in the patient. - A history of past violence is described as the foremost indication of a new violence.

Referencat

1. How stigma interferes with mental health care. Am Psychol 2004;58:614–Pescosolido BA, Monahan J, Link BG, et al
The public's view of the competence, dangerousness, and need for legal coercion of persons with mental health problems. Am J Public Health 1999;89:1339–45.
2. World report on violence and health. Geneva: World Health Organization; 2002. Choe JY, Teplin LA, Abram KM

2. DHUNA NË FAMILJE NDIKON NË SHËNDETIN MENDOR TË GRAVE

Anila Hashorva, P. Bileri
Psikiatre QSUT "Nënë Tereza", Tiranë

Çdo javë në Britaninë e Madhe, një grua vritet nga dikush që e njeh (partner ose ish-partneri).

1 në 3 gra ka pësuar dhunë fizike që nga moshën 15 vjeçare. 1/4 e grave angleze kanë pësuar abuzim emocional nga partneri i cili kërkon të fitojë kontrollin psikologjik dhe emocional të

gruas duke e dëmtuar, kontrolluar veprimet e saj, duke u abuzuar verbalisht dhe duke e frikësuar. Abuzimi fizik dhe emocional është psikologjikisht dëmtues dhe rrit rrezikun për zhvillimin e një sëmundjeje mendore.

Më shumë se 57 milionë njerëz në *Shtetet e Bashkuara* (mbi 18 vjeç) vuajnë nga një sëmundje mendore. Më shumë se 50% e tyre kanë përjetuar më parë ndonjë traumë të tillë si abuzimi fizik ose seksual.

Ky referim do të sjellë rezultatet e dy studimeve të bëra në Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara në vitet 2015-2018 mbi ndikimin që ka dhuna në familje në shëndetin mendor të grave, në grupet respektivisht prej 1570 dhe 2800 viktime të dhunës.

Rezultatet treguan se: 54%-84% e grave të dhunuara vuajnë nga PTSD, 63%-77% përjetojnë depresion, 38%-75% vuajnë nga ankthi, 13% e tyre kishin tentuar mbi një herë për vetëdëmtim.

Konkluzionet: Të jetosh nën ndikime të dhunës fizike dhe emocionale do të të cojë në pasoja të mirëqenies mendore. Rritet risku për të përjetuar **PTSD** 7 herë më shumë, për **Depresionin** 2.7 herë, për **Ankthin** 4 herë më shumë, keqpërdorimi i **drogës dhe alkoolit** 6 herë më shume. Mundësia për të pasur **mendime vetëvrasëse** ishte 3.5 herë më e madhe për gratë që kishin përjetuar dhunë në familje sesa ato që nuk kishin.

Domestic violence affects women’s mental health

Every week in Great Britain, a woman is murdered by someone she knows. 1 in 3 women has suffered physical violence since the age of 15. 1/4 of British women have suffered emotional abuse from a current or ex partner. Physical and emotional abuse is not only distressing, it’s psychologically damaging and increases women’s risk of developing a mental illness.

More than 57 million people in the United States (age 18 and older) suffer from a mental illness. Over 50% of women who live with a mental illness have previously experienced some sort of trauma such as physical or sexual abuse (either during childhood or adulthood). Domestic violence can cause an adverse ripple effect on the emotional and psychological state of a survivor.

Research indicates: 54% to 84% of battered women suffer from PTSD, 63% to 77% of battered women experience depression, and 38% to 75% experience anxiety.

No wonder living under such physical and emotional pressure impacts on mental and physical well-being. The study found that PTSD was about 7 times higher for women who had been victims of domestic violence than those who had not, developing depression was 2.7 times greater, anxiety four times greater, and drug and alcohol misuse six times greater, having suicidal thoughts was 3.5 times greater for women who had experienced domestic violence than those who hadn’t.

Referencat

1. Violence against women and mental disorder: a qualitative study in Great Britain
Trop Med Health. 2018; 46: 5. Published online 2018 Mar 1. doi: 10.1186/s41182-018-0085-x PMID: PMC5831218 PMID: [29507506](#)
2. How domestic violence affects women’s mental health
Published online February 18, 2019 7.06pm GMT PMID: PMC4493472
Women who have been victims of domestic abuse may experience depression, anxiety

3. MOBBING

Kreshnik Idrizaj, A. Saliu , L.Tepshi

Rezident i Psikiatrisë, Shërbimi i Psikiatrisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Tiranë

Hyrje: *Mobbing* rrjedhë nga fjala/folja *to mob* që do të thotë të sulmosh/të dhunosh/të ngacmosh dikë në vendin e punës. *Mobbing* paraqet sjellje agresive psikofizike dhe verbale ekzekutuar nga disa njerëz, drejtuar një ose disa individëve të tjerë me qëllim denigrim/shkatërrim të personit ose personave që sulmohen.

Metodika: U kërkuan dhe u grumbulluan nga PUBMED (344 artikuj), PMC (744 artikuj), THE AMERICAN JOURNAL OF PSYCHIATRY (163 artikuj). Kërkimi i artikujve u realizua duke vendosur në domain-in e kërkimit të këtyre platformave fjalën *Mobbing*. Rezultatet e artikujve me impaktin më të madh, u grumbulluan dhe u analizuan në mënyrë krahasimore me njëra tjetrën.

Rezultati: *Mobbing* ka pasoja shkatërruese tek individ duke i shkaktuar çrregullime të rëndësishme psiko-somatike dhe efekte të rëndësishme sociale

Mobbing

Introduction: *Mobbing* is derived from the word / verb *to mob* which means to assault / violate / harass someone in the workplace. *Mobbing* represents an aggressive psychophysical and verbal behavior executed by a group of persons, directed at one or more individuals for the purpose of denigrating / destroying the person or persons being attacked.

Methods: There have been searched and collected by PUBMED (344 articles), PMC (744 articles), THE AMERICAN JOURNAL OF PSYCHIATRY (163 articles). The search for articles was done by placing the word *Mobbing* on the search domain of these platforms. The results of the items with the highest impact were collected and analyzed in a comparative manner.

Result: *Mobbing* has devastating effects over the individual, causing significant psycho-somatic disorders and significant social effects

Referencat:

1. Appleby, L., et al. (1997). The impact of substance use screening on a public psychiatric inpatient population. *Psychiatric Services* 48: 1311 – 6. PubMed
2. Vos, T., et al. (2013) Global, regional, and national incidence, prevalence, and years lived with disability for 301 acute and chronic diseases and injuries in 188 countries, 1990–2013: a systematic analysis for the Global Burden of Disease Study. *The Lancet*.

4. TRAJTIMI I TË SËMURËVE MENDORË NË SPITALIN PSIKIATRIK "Ali Mehmeti", VLORË

Ejona Zilja

Shefe e Shërbimit Akut, Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë

Objekt i këtij punimi është historiku i trajtimit të të sëmurëve mendorë në 100 vitet e fundit, në institucionin e parë të shëndetit public në Shqipëri, Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë. Rrethanat e veçanta të hapjes së tij nën kujdesin e Qeverisë Italiane në vitin 1921 në bashkëpunim me personel shqiptar (mjeku Sezai Como), para qesin fakte unike për të kuptuar evoluimin e këtij shërbimi në vend si Shqipëria. Me një përzgjedhje interesante të historikut të pacientëve të ndryshëm nga gjithë vendi në kushtet e izolimit, punimi tenton të hedhë dritë jo vetëm mbi ndryshimet por edhe të krahasojë etapa të caktuara të shërbimit sipas kontekstit dhe rrethanave historike (periudha e Zogut, periudha e regjimit komunist, periudha e postkomuniste).

Qëllimi i këtij referati është evidentim dhe analize krahasuese e trajtimit të të sëmurëve mendorë në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", që prej fillimit të shekullit të 20-të deri në ditët tona.

Disa nga kënd vështrimet mbi të cilat do të ndërtohen tezatat e punimit janë: 1. Violenca/keq trajtimi ndaj të sëmurëve, 2. Trajtimi mjekësor, 3. Politikat e ndjekura nga Qeveritë mbi shëndetin mendor.

Metoda: Si material për studim janë përdorur dosje nga Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi i Prefekturës dhe Bashkisë Vlorë, Fondi i Spitalit Psikiatrik Vlorë, material të mbledhura nga puna e mjekëve ndër vite, kartoteka e spitalit si dhe shënime personale të familjarëve të personelit pranë këtij spitali.

Përfundime: Trajtimi i të sëmurëve mendorë që prej fillesave ka qenë një sfidë edhe për vendet më të zhvilluara e demokratike. Në rastin e Shqipërisë pikëpyetjet janë edhe më të mëdha nga mungesa e institucioneve të konsoliduara dhe ligjshmërisë dhe veçanërisht nga konteksti

kulturor. Stigma, dikriminimi, violenca, keqtrajtimi kanë qënë bashkëudhëtare me këta persona përvite me radhë. Në spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë pas afro një shekulli standardi I trajtimit të të sëmurit mendor mund të quhet bashkëkohor, por gjithmonë ka vend për përmirësim. Motoja e mjekut të sotëm është **fjala**, forca e fjalës asnjehere nuk duhet të humbas vlerën. Fjala “shëron”, ndërsa dhuna krijon premise për një dhunë të ridimensionuar.

The treatment of patients with mental disorder in Psychiatric Hospital in "Ali Mihali", Vlorë

The subject of this paper is the history of the treatment of the mentally ill in the last 100 years, at the first mental health institution in Albania, the Psychiatric Hospital "Ali Mihali" Vlorë. The special circumstances of its opening under the auspices of the Italian Government in 1921 in collaboration with Albanian staff (doctor Sezai Como) present unique facts to understand the evolution of this service in a country like Albania. With a fascinating selection of different patients histories across the country in isolation conditions, the paper attempts to shed light not only on the changes but also to compare certain stages of service according to context and historical circumstances (the Zog period, the communist regime period), the post-communist period).

The purpose of this report is to identify and compare the treatment of the mentally ill at the “Ali Mihali” Psychiatric Hospital from the beginning of the 20th century to the present days.

Some of the perspectives on which the thesis will be built are: 1. Violence / mistreatment of the sick, 2. Medical treatment, 3. Governments' policies on mental health.

Method: Materials for the study are taken from the Central State Archives Files, the Vlorë Prefecture and Municipality Fund, the Vlorë Hospital Fund, materials collected from doctors' work over the years and the hospital's file and personal records of staff members hospital.

Conclusions: Treating the mentally ill from the beginning has been a challenge for even the most developed and democratic countries. In the case of Albania, the questions are further compounded by the lack of consolidated institutions and legality, and in particular by the cultural context. Stigma, discrimination, violence, mistreatment have been with these people for years. At the “Ali Mihali” Psychiatric Hospital in Vlorë after nearly a century the standard of treatment for the mentally ill can be called contemporary, but there is always hope for improvement. The motto of today's doctor is the “word”. The power of speech should never lose its value. The word "heals", while violence creates the premises for resized violence.

Referenca:

1. Vos, T., et al. (2013) Global, regional, and national incidence, prevalence, and years lived with disability for 301 acute and chronic diseases and injuries in 188 countries, 1990–2013: a systematic analysis for the Global Burden of Disease Study. *The Lancet*.

5. DHUNA NDAJ KAPACITETIT INTELEKTUAL TË PERSONAVE TË GJINISË FEMËRORE

Sylen Vranica, G. Retkoceri, G. Elezi, L. Alidema, S. Krasniqi, I. Vraniqi

Qëllimi: Është që të paraqitet krahasimi në mes të kapacitetit intelektual të gjinisë femërore dhe asaj mashkullore.

Metoda e punës: Intervistimi është bërë në ambientet e poliklinikës “Shëndeti im” në Prishtinë. Është përdorur pyetja e parashtruar për gjininë femërore në formën: “cili person i thotë fëmiut të të vet ti je fëmiu im ndërsa unë nuk jam nëna yte”? me përgjegje të saktë: babai, ndërsa, për personat e gjinisë mashkullore, pyetja ka qenë në formën: “cili person i thotë fëmiut të të vet ti je fëmiu im ndërsa unë nuk jam babai yt” me përgjegje të saktë: nëna

Rezultatet: Është marrë mostra prej gjithsej 100 personave, 50 të gjinisë femërore dhe 50 të gjinisë mashkullore. Kriteri ka qenë që të intervistuarit të jenë të martuar dhe të kenë fëmijë.

Diskutimi: Përgjigje të sakta kanë dhënë 11 persona apo 12% të gjinisë femërore, ndërsa tek meshkujt kemi pasur 2 përgjigje të sakta apo 4%. Përgjigjet e sakta kanë qenë në nivel tejet të ulët tek të dy gjinitë, sidomos tek gjinia mashkullore.

Përfundimet: Edhe pse personat e gjinisë femërore, në përgjithsi, janë në mënyrë emocionale më të pasura, ato prap se prap, pothuajse, tri (3) herë më tepër janë më të sakta dhe të koncentruara se meshkujt! Kjo e dhënë të imponon të mendosh se në mesin tonë, pothuajse, aspak nuk mundohen të përqëndrohen në mënyrë logjike dhe të japin përgjigje të saktë!

Rekomandimet: Duke marrë parasysh të dhënat e prezantuara, tani në kohën kur duhen bisedimet serioze me shtetin fqinj si edhe për ardhmërinë e shtetit tonë, gjithsesi duhet të ngritet numri i pjesëmarrësve të gjinisë femërore, duke shpresuar në përmirësimin e situatës mbretëruese.

Violence against the intellectual capacity in the female gender

The paper presents the results of the survey of male and female persons. According to our results which take into consideration the age of 50 women and 50 men, women came up in 11 instances with correct results or 22%, whereas men only 2 instances or 4%, and despite these results, women in our society are not respected in comparison to men.

Referencat

1. Brownridge, DA. (2006). Violence Against Women 12(9): 805 – 22 PubMed.
2. Walker, LE. (1989). Psychology and violence against women. American Psychologist 44(4): 695 – 702.

6. MBIPOPULLIMI DHE DHUNA NË PAVIONET PSIKIATRIKE

Lefter Sinani, V. Kola, A. Suli
Shërbimi i psikiatrisë, QSU "Nënë Teresa", Tiranë.

Hyrja: Mbipopullimi dhe sjellja violente e pacientëve janë dy probleme madhore në kujdesin shëndetësor psikiatrik. Megjithatë, të dhënat e një lidhjeje midis mbipopullimit dhe sjelljes agresive të pacientëve janë mikste dhe të limituara në studime.

Qëllimi: Ky studim përqipet të ekzaminojë lidhjen midis mbipopullimit në pavione dhe sjelljes violente.

Metoda: Shqyrtimi sistematik i të dhënave mbi mbipopullimin nëpër pavione akute psikiatrike. Të dhëna nga një studim kohort prospektiv, 24 javor, pacientëve të shtruar në spitalin psikiatrik në QSU "Nënë Tereza" Tiranë. Studimet mbi geriatrie dhe fëmijët e adoleshentët janë përjashtuar.

Rezultate: Sipas të dhënave ka lidhje midis mundësisë së rrezikut që një individ të jetë i dhunshëm dhe mbipopullimit. Shkallë e lartë e dhune raportohet në korridorin e pavionit. Disa studime kanë treguar se incidentet më të dhunshme ndodhin në njësi, ku numri i pacientëve është i lartë. Janë raportuar gjithashtu edhe gjetje zero dhe madje rezultati i kundërt ku mbipopullimi i pacientëve lidhet me një rrezik më të ulët të dhunës.

Konkluzione: Këto gjetje sugjerojnë që mbipopullimi me pacientë është mjaft i shprehur në spitalet psikiatrike dhe kjo sjell rritjen e rrishtit për dhunë verbale dhe ndaj stafit.

Overcrowding and violence in psychiatric wards.

Background: Patient overcrowding and violent assaults by patients are two major problems in psychiatric healthcare. However, evidence of an association between overcrowding and aggressive behaviour among patients is mixed and limited to small-scale studies.

Aims: This study examined the association between ward overcrowding and violent physical assaults in acute-care psychiatric in-patient hospital wards.

Method: Systematic review of the data available for Ward Crowding on Acute Psychiatric Inpatient Units. Prospective cohort study, during 24 weeks with patients admitted in psychiatric hospital on UHC “Mother Tereza” Tirana. Papers on psychogeriatric and child and adolescent wards were excluded.

Results: According to the data, there are links between an individual’s risk of being violent and overcrowding. The high rate of violence is reported in hallway. Some studies have shown that more violent incidents occur in the unit when the numbers of patients is high. However, null findings and even the opposite result, whereby patient overcrowding is related to a lower risk of violence, have also been reported.

Conclusions: These findings suggest that patient overcrowding is highly prevalent in psychiatric hospitals and, importantly, may increase the risk of violence directed at staff.

Referencat

1. Ward Crowding and Incidents of Violence on an Acute Psychiatric Inpatient Unit
Bradley Ng, M.B., Ch.B. Shailesh Kumar, M.R.C.Psych., M.Phil. Marita Ranclaud
Elizabeth Robinson (Psychiatric Services 52:521–525, 2001)
2. BJP 2011 198:149-155 Marianna Virtanen, Jussi Vahtera, G. David Batty, Katinka
Tuisku, Jaana Pentti, Tuula Oksanen, Paula Salo, Kirsi Ahola and Mika Kivimäki.
Overcrowding in psychiatric wards and physical assaults on staff: data-linked
longitudinal study.

7. VIOLENCA DHE MEDIA SOCIALE NË SHËNDETIN MENDOR TË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Kledi Lame, J. Saraci, E. Tashi
Psikiatre për fëmijë dhe adoleshentë në QKSHM- Shkodër

Perdorimi i internetit dhe i mediave digitale analoge edhe rritur në mënyrë eksponenciale në mbarë botën gjatë viteve tëfundit. Në të vërtetë, në mesin e vitit 2016 kishte një shkallë depërtimi ne pothuajse gjysmës së popullsisë së botës .

Për 20 vitet e fundit, rëndësia e rritjes se perdorimit te internetit dhe mediave te lidhura më shumë se 900% nga 2010 në 2016. Rritja më e shpejtë u gjet ne rajonet e Bashkimit Evropian, ku në vitin 2016, gati 80% e popullsisë së përgjithshme po përdorte internetin. Statistikat e viteve te fundit kokefortesisht mbeshtesin rritjen e perdorimit. Ndërsa ky trend është vërenjtur në të gjitha grup-moshat, por adoleshentët, në veçanti, miratojnë shpejt teknologjitë e reja. Pothuajse 100% e adoleshentëve përdorin internet në baza ditore, më shumë se 80% e përdorin atë në lëvizje, dhe më shumë se 50% e konsiderojnë atë "të domosdoshëm".

Por rritja e perdorimit te internetit dhe mediave sociale ka cuar pashmangmerisht ne rritjen e ekspozimit ndaj llojeve më të zakonshme të dhunës së të rinjve në mediat sociale si : ngacmimi në internet (cyber bullying)/ viktimizimi, persekutimi, agresioni elektronik i te dhenave / kërcënimi në internet, dhuna në banda, dhuna nga shokët, e deri në të shtënat në shkollë dhe vetëvrasjet në internet (Patton, Eschmann, & Butler, 2013, f. 549) .

Ybarra, Diener-West dhe Leaf (2007) zbuluan se viktimat e sulmit kibernetik kishin 1.5 herë më shumë të ngjarë të benin tentativa vetëvrasje se sa ata që nuk ishin as viktimë e as kryerës të sulmit në internet.

Sot, ekziston një konsensus i përgjithshëm që media e dhunshme mund të kontribuojë që fëmijët të veprojnë në mënyrë agresive, ndaj do vleresojmë lidhjen sinjifikante mes violences qe shfaqet ne media sociale dhe disa modele karakteristike te psikopatologjise me crregullime internalizuese dhe eksternalizuese te femijeve dhe sidomos adoleshenteve dhe adulteve te rinj.

Violence and Social Media in Child and Adolescent Mental Health

The use of internet and analogue digital media has also grown exponentially worldwide in recent years. Indeed, by mid-2016 there was a rate of spreading in almost half of the world's population.

For the past 20 years, the importance of increasing Internet and related media use has increased by more than 900% from 2010 to 2016. The fastest growth was found in European Union regions, where in 2016 nearly 80% of the population general was using the internet. Recent years statistics strongly support increased use. While this trend has been observed across all age groups, adolescents, in particular, are rapidly adopting new technologies. Almost 100% of teens use the internet on a daily basis, more than 80% use it on the go, and more than 50% consider it "necessary".

But increased use of the Internet and social media has inevitably led to increased exposure to more common types of youth violence on social media such as cyber bullying / victimization, persecution, electronic data aggression / threat cyberbullying, gang violence, school shootings,

and online suicide (Patton, Eschmann, & Butler, 2013, 549).

Ybarra, Diener-West, and Leaf (2007) found that cyberattack victims were 1.5 times more likely to commit suicide attempts than those who were neither victims nor perpetrators of cyberattacks. Today, there is a general consensus that violent media can contribute to children acting aggressively, so we will estimate the significant link between social media violence and some characteristic patterns of psychopathology with internalizing and externalizing disorders in children and especially adolescents and young adulthood.

8. ZHGËNJIMI I “MADAM BOVARI”

Valmira Skendi, V. Alikaj, E. Spaho

Psikologe klinike, PhD. Shërbimi i Psikiatrisë së Fëmijëve /Adoleshentëve. QSU “Nënë Tereza” Tiranë. Pedagoge e Jashtme pranë Fakultetit të Mjekësisë

Çrregullimi i Konversionit përbën një tërësi simptomash neurologjike të cilat manifestohen pa një shkak organik, të hipotetizuara si përgjigje ndaj stresit të tejskajshëm emocional, anomalive në procesimin emocional dhe atë emocionalo-motorik (DSM 5, 2013). Simptomat përjetohen si reale e nuk janë imagjinare dhe mund të prekin funksionet motore dhe ndjesore. Konceptet teorike të konversionit, disosacionit dhe somatizimit, janë historikisht të lidhura me konceptin e histerisë së hershme Freudiane.

Objektivi i këtij studimi është analiza e përmbledhur e tre rasteve klinike të paraqitura për të marrë shërbim në Klinikën e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve (PFA), QSUT, nëpërmjet shpjegimit dhe identifikimit të koncepteve të frustrimit ndaj stresorëve e mungesave tek këta pacientë.

Metoda kryesore e studimit është hulumtimi i literatures ekzistente mbi origjinën dhe manifestimin e simptomave disociative në çrregullimet e konversionit. Gjithashtu u realizua shqyrtimi i dokumentacionit klinik dhe shkrimit të ditareve dhe detyrave kognitive të këtyre pacienteve.

Rezultat: Simptomat disociative janë të shpeshta në çrregullimet e konversionit. Nevoja të frustruara në shfaqjen e simptomave përbënin thelbin e vlerësimit gjatë ofrimit të vlerësimit dhe ndihmës psikologjike më këta pacientë. Këto frustrime kanë të bëjnë me ngjarje jetësore të keqpërfjetuara dhe të fiksuara në mendje si barrier për të vazhduar jetën njësoj. Gjithashtu këto përjetime mugesash përbënin motiv për të gjetur kuptim e shpëtim tek simptomatika e manifestuar. Këto simptoma disociative shoqëroheshin shpesh me frustrime që kanë të bëjnë me “nevojën për dashuri”, “boshllëkun emocionale” dhe “nevojën për vetvlerësim”.

Konkluzion: Simptomat disociative të manifestuara tek pacientët me klinikë konversioni kanë lidhje me nivelin e frustrimit në një realitet të keqperceptuar apo të keqpërfjetuar ku filtrohen vetëm eksperiencat negative dhe mungesat në përmbushjen e nevojave emocionale e personale të përjetuara së brendshmi.

The disappointment of “Madam Bovari”

Conversion Disorder is a set of pseudo neurological symptoms manifested without an organic cause, hypothesized in response to excessive emotional stress, abnormalities in emotional processing and emotional-motor processing (DSM 5, 2013). The symptoms are experienced as real and not imaginary and can affect motor and sensory functions. The theoretical concepts of conversion, dissociation and somatization are historically linked to the concept of early Freudian hysteria.

The **objective** of this study is to summarize the analysis of three clinical cases presented for admission to the Pediatric and Adolescent Psychiatry (PFA) Clinic, TUHC, by explaining and identifying concepts of frustration with stressors and shortages in these patients.

The main **method** of the study is to research existing literature on the origin and manifestation of dissociative symptoms in conversion disorders. A review of the clinical documentation and writing of the diaries and cognitive tasks of these patients was also conducted.

Results: Dissociative symptoms are common in conversion disorders. Frustrated needs in the onset of symptoms constituted the core of the assessment when providing assessment and psychological assistance to these patients. These frustrations relate to misplaced and fixed-minded life events as a barrier to continuing life the same. also these experiences of misery were the motive for finding meaning and salvation in the manifested symptom. These dissociative symptoms were often associated with frustrations related to "need for love", "emotional emptiness" and "need for self-esteem".

Conclusion: The dissociative symptoms manifested in patients with conversion clinics relate to the level of frustration in a misunderstood or misperceived reality where only negative experiences and deficits in meeting the internally experienced emotional and personal needs are filtered out.

Referencat

1. Ejareh dar M, Kanaan R, Uncovering the etiology of conversion disorder: insights from functional neuroimaging. Department of Psychiatry, University of Melbourne, Austin Health, Heidelberg, VIC, Australia, 2015.
2. Reiji Ishikura, et al., Frustration and fulfillment of needs in dissociative and Conversion disorders Psychiatry and Clinical Neurosciences (2002), 56, 381–390, Department of Neuropsychiatry, Graduate School of Medical Sciences, Kyushu University, Fukuoka, Japan

9. QËNDRIMET KUNDREJT ÇRREGULLIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR NË KOMUNITETIN SHQIPTAR

Enita Metaj, V.Alikaj, E. Dashi, J. Beci

Hyrje: Problemet e shëndetit mendor janë një nga shkaqet kryesore të barrës së përgjithshme të sëmundjeve në të gjithë botën. Vlerësohet se 1 në 6 persona gjatë javës së fundit, përjeton një problem të shëndetit mendor. Incidenca, prevalenca dhe prognoza e çrregullimeve mendore është e lidhur ngushtë me faktorë të komunitetit. Disponueshmëria dhe integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet mund të promovojë aksesueshmërinë, pranueshmërinë, si dhe të promovojë respektimin e trajtimit dhe të rrisë mundësinë e rezultateve pozitive klinike.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të përcaktojë njohuritë, perceptimin dhe qëndrimet e popullatës në Shqipëri lidhur me çështjet që i përkasin shëndetit mendor si dhe të identifikojë parashikuesit socio-demografikë të njohurive të sakta dhe qëndrimeve të favorshme.

Metoda: Pyetësori CAMI (Community Attitudes to Mental Illness), Taylor M., Dean M. 1970, u përkthye, përshtat dhe shpërnda në format elektronik, për t’u plotësuar online, në individë adultë (>18 vjeç), të niveleve të ndryshme të edukimit, përdorues të pajisjeve teknologjike (telefona celularë, kompiuter) gjatë periudhës 01 Korrik -31 gusht 2019.

Rezultate: U grumbulluan të dhëna mbi këndvështrimin dhe përshtypjet e Komunitetit Shqiptar për sa i përket shërbimeve të shëndetit mendor, qasjeve më të mira të trajtimit të individëve që vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor sipas tyre, nivelin e përgjegjësisë që ata mendojnë që duhet t’i lihet këtyre individëve, dhe sugjerime konkrete lidhur me përmirësimin e sistemit. Të dhëna këto që janë ende në përpunim.

Konkluzione: E rëndësishme është që individët e komunitetit të kenë informacionin e duhur dhe qasje sa më pozitive e pranuese ndaj sëmundjeve të shëndetit mendor dhe personave që vuajnë prej tyre. Më shumë përpjekje për të sfiduar qasjet negative dhe stigmën duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse.

Fjalët kyçe: Sëmundje psikiatrike, shëndet mendor, spitale psikiatrike, stigma.

Attitudes toward mental health disorders in the Albanian community

Introduction: Mental health problems are one of the major causes of the overall burden of disease worldwide. It is estimated that 1 in 6 people during the last week experiences a mental health problem. The incidence, prevalence, and prognosis of mental disorders are closely related to community factors. The availability and integration of community mental health services can promote accessibility, acceptability, treatment adherence and increases the likelihood of positive clinical outcomes.

Aim: This study aims to determine the knowledge, perception and attitudes of the Albanian Community regarding mental health issues and to identify socio-demographic predictors of accurate knowledge and favorable attitudes.

Method: The CAMI (Community Attitudes to Mental Illness) Scale, Taylor M., Dean M. 1970, was translated, adapted and distributed electronically, to be completed online, in adult individuals (> 18 years), of different levels of education, users of technological equipment (cell phones, computers) during the period 01 July -31 August 2019.

Results: Data were collected on the views and attitudes of the Albanian Community regarding mental health services, the best treatment approaches for people suffering from mental health disorders, the level of responsibility they feel should be left to these individuals, and concrete suggestions for improving the system. Data is still being processed.

Conclusion: It is important that community individuals have the right information and the most positive and acceptable approach to mental health illnesses and persons suffering from them. More efforts to challenge negative approaches and stigma should be undertaken by responsible institutions.

Key words: Psychiatric illness, mental health, psychiatric hospitals, stigma.

Referencat

1. S. M. Taylor, M. J. Dear (1981) Scaling Community Attitudes Toward the Mentally Ill PubMed.
2. Vos, T., et al. (2013) Global, regional, and national incidence, prevalence, and years lived with disability for 301 acute and chronic diseases and injuries in 188 countries, 1990–2013: a systematic analysis for the Global Burden of Disease Study. *The Lancet*.

10. ADVOKACIA, SI NJË MËNYRË PARANDALIMI I AUZIMIT ME TË DREJTAT E PACIENTËVE TË SHËNDETIT MENDOR

Dhurata Ejupi, V. Skendi, T. Mana

Punonjëse sociale, Msc, PAI Neuroshkncës, QSU “Nënë Tereza” Tiranë.

Advokacia, mbrojtja e të drejtave të pacientëve me probleme të shëndetit mendor përbën një mision kyc për punonjësit social të shëndetit mendor, njëkohësisht pjesë e rëndësishme e ekipit multidisiplinar.

Është pikërisht përpjekja për të drejtat sociale, ajo që dallon punonjësit social nga profesionet e tjera! (Anne Marie Mc Laughlin, 2009)

Objektivat: Të trajtojë se misioni i Punonjësit social në thelb synon të përmbushë nevojat e individëve me probleme të shëndetit mendor. Ky target grup përbën një komunitet mjaft

vulnerabël në rrisht që nga familja e deri në komunitet për tu bërë pre e dhunimit, shfrytëzimit, si edhe abuzimit me të drejtat e tyre.

Metoda: Analizë e disa rasteve të pacientëve të paraqitur në shërbimin e psikiatrisë për të marrë ndihmë të specializuar.

Rezultatet: Ne shumicën e rasteve të identifikuar hasen mjaft vështirësi në lobimin, negocimin me familjet dhe institucionet e përfshirane problem zgjidhje.

Pacientet e shëndetit mendor vuajnë krahas sëmundjes edhe mohimin e të drejtave, si cilesia e jetës, ngritjen profesionale, punësimin etj.

Advocacy as a way to prevent the abuse of the rights of patients with Mental Health problems!

Advocacy, the protection of the rights of patients with mental health problems is a key mission for mental health social workers, at the same time an important part of the multidisciplinary team! It is precisely the striving for social rights that distinguishes social workers from other professions! (Anne Marie Mc Laughlin, 2009)

Objectives: To address that the Social Worker's mission is essentially intended to meet the needs of individuals with mental health problems. This target group is a very vulnerable community at risk from the family to the community, exploited, and abused for their rights!

Method: Analysis of some cases of patients referred to the psychiatric service to receive specialized help!

Results: In most of the cases identified, many difficulties are encountered in lobbying, negotiating with families and institutions involved in problem solving! Mental health patients suffer besides illness and denial of rights, such as quality of life, professional development, employment, etc.!

Referenca

1. Anne Marie Mc Laughlin, Clinical social workers: (Advocates for social Justice) (Advances in social work 2009)

11. SHËNDETI MENDOR DHE DHUNA E NDËSHKUAR NGA LIGJI

Ermira Qirinxhi, M. Tollozhina
Psikiatre, Qendra Spitalore e Burgjeve

Objektivi: Të sëmurë mendor, që kanë marrë vendimin e forms së prerë për veprat: dhunë dhe krim në familje.

Metoda: Pacientët e akomoduar në spitalin e burgjeve, të gjithë të vlerësuar me ESM, plotësuar anamneza vitae nga të dhënat e familjarëve si dhe plotësimet me ekzaminimet e nevojshme për përjashtimin e problemeve organike.

Rezultati: 30 pacientë të hospitalizuar, prej të cilëve 15 femra e 15 meshkuj. Prej femrave, 10 të diagnostikuara në jetë të lirë por jo të rregullta në marrjen e mjekimit. Prej meshkujve 12 të diagnostikuar pas kryerjes së veprës penale. Prej femrave 6 të diagnostikuara me skizofreni, 5 bipolare, 4 Skizoafektive dhe 1 Çrregullim personaliteti. Nga meshkujt 3 raste komorbiditet të çrregullimeve psikiatrike me abuzim me LN dhe një rast abuzimi me alkool.

Konkluzioni: 1) Shtimi i qendrave komunitare nëpë rrreth edhe 2) gjetja e politikave të projekteve për t’i ardhur në ndihmë populates për evidentimin e simptomave që në faze të hershme në mënyrë që të trajtojmë e jo të burgosim të sëmurët e shëndetit mendor

Mental health and violence punished by the law

Objective: Mentally ill, who made the final decision on offenses: domestic violence and crime.

Method: Patients accommodated at the prison hospital center, all assessed with MSE, completed accurate anamneses from family records as well as supplementation with examinations needed to rule out organic problems.

Result: 30 hospitalized patients, 50% males and 50% females. 10 females were diagnosed before committing the crime but had not taken the treatment regularly. 12 males were diagnosed after committing the offense. Six females are diagnosed with schizophrenia, five are diagnosed with bipolar disorder, four with schizoaffective disorder and 1 personality disorder. Three cases (males) had mental illness with comorbid drug and alcohol abuse.

Conclusion: 1) Increasing community centers across districts and 2) Finding policies and projects to help the population identify symptoms at an early stage in order to treat rather than incarcerate mentally ill patients.

Referenca

1. Vos, T., et al. (2013) Global, regional, and national incidence, prevalence, and years lived with disability for 301 acute and chronic diseases and injuries in 188 countries, 1990–2013: a systematic analysis for the Global Burden of Disease Study. *The Lancet*

12. KUSH ËSHTË PACIENTI I VËSHTIRË DHE SI MANAXHOHET AI NË SHËRBIMIN E URGJENCËS

Valbona Alikaj, V. Skëndi

Psikiatre, Departamenti i Neuroshkencës, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë Shqipëri

Studime të ndryshme janë marrë me identifikimin dhe vlerësimin e karakteristikave të pacientëve të vështirë (P.V.) dhe sfidues të paraqitur në Shërbimet e Urgjencave. P.V. përfshijnë një kategori të gjerë të diagnozave, dhe ka më shumë se 60 vjet që ekziston një sistem klasifikimi i pacientëve problematikë, i cili ndihmon klinikistët të kuptojnë dhe të planifikojnë reagimet ndaj tyre (Strous RD e bp., 2006).

Qëllimi: Të diskutohen disa nga problemet kryesore me të cilat hasen sot mjekët në Sh.U. dhe që kanë lidhje me njohjen dhe menaxhimin e P.V.

Pyetjet më të shpeshta që ngrihen janë: si mundet mjeku që të arrijë të njohë një pacient të vështirë? Kush mund të jetë ai pacient që mund ta bëjë mjekun të ndihet i paaftë, i frustruar apo edhe burned out? Cilat janë shkaqet që e bëjnë një ndërveprim terapeutik të vështirë? Si mund të menaxhohen këta pacientë?

Vlerësohet që 20% e ndërveprimeve në Sh.U. të SHBA kanë qenë të vështira, ndërkohë që vetëm 0.2% e popullatës është përdoruese me frekuencë të shtuar e Sh.U. (N. Moukaddam e bp., 2017). Në pjesën më të madhe P.V. janë ata me çrregullime të personalitetit, “përsëritësit”, apo “pacientët e rregullt” si dhe ata me sjellje adiksioni. Ata shpesh kërkojnë vëmendje të menjëhershme, kanë tolerancë të dobët ndaj frustrimit, dhe krijojnë marrëdhënie negative me të tjerët, duke shkaktuar tek klinikistët ndjenja ankthi, ambivalencë, zemërim, inat dhe frikë.

Përfundime: megjithë unikalitetin e çdo interviste të vështirë klinike, njohuritë mbi disa veçori kyçe duken të jenë të vlefshme në menaxhimin e situatave të vështira në Sh.U.. Një strategji efektive për të realizuar këtë objektiv, është të vendoset qartë që disa sjellje janë të papranueshme dhe arsytet përse janë të tilla (Benjamin J. Sadock, e bp., 2005).

Who is the Difficult Patient and how is he managed in the Emergency Service?

Various studies have been conducted to identify and evaluate the characteristics of difficult and challenging patients (DP) presented in Emergency Services (ES). DP include a broad category of diagnoses and for more than 60 years, there has been a classification system of problematic patients, which helps clinicians understand and plan their reactions (Strous RD e bp., 2006).

Aim: To discuss some of the major problems that physicians in the ES face today, that relate to the recognition and management of DP.

The most frequently asked questions are: how can a doctor recognize a difficult patient? Who might be that patient that can make the doctor feel incompetent, frustrated or even burned out? What are the causes that make a therapeutic interaction difficult? How can we manage these patients?

It is estimated that 20% of US interactions in the ES have been difficult, while only 0.2% of the population are a frequent ES user (N. Moukaddam e bp., 2017). Most of DP are those with personality disorders, "repeaters", or "regular patients" and those with addictive behaviors. They often require immediate attention, have a low tolerance to frustration, and develop negative relationships with others, causing clinicians to experience anxiety, ambivalence, anger, rage and fear.

Conclusions: despite the uniqueness of any difficult clinical interview, knowledge of some key features appears to be valuable in managing difficult situations in the ES. An effective strategy to accomplish this objective is to clearly state that certain behaviors are unacceptable and the reasons why they are so (Benjamin J. Sadock, e bp., 2005).

Referencat

1. Strous RD, Ulman AM, Kotler M. The hateful patient revisited relevance for 21st century medicine. Eur J Intern Med. 2006; 17(6):387-393.
2. N. Moukaddam, A. Flores, A. Matorin, N. Hayden, V. TheresaTucci. Difficult Patients in the Emergency Department: Personality Disorders and Beyond. Psychiatr Clin N Am 40 (2017) 379–395.

13. MITET DHE REALITETI MBI DHUNËN PSIKIATRIKE: Perceptimi i opinionit publik dhe evoluimi i opinionit shkencor mbi këtë çështje

Sadik Lala

Psikiatër, Klinika VENIS

OBSH e ka përkufizuar dhunën si “...përdorim të qëllimshëm të forces fizike ose fuqisë, si kërcënim apo veprim faktik kundër vetvetes, kundër një personi tjetër ose kundër një grupi ose bashkësie, e cila ose rezulton ose ka gjasë të lartë të rezultojë në lëndime, vdekje, dëmtime psikologjike ose privim...”. Përkufizimi gjithëpërfshirës i OBSH-së përqëndrohet më tepër në pasojat e saj në shëndet dhe mirëqenie se sa në karakteristikat e dhunës si një konstruksion shoqëror ose kulturor.

Studiuesit gjithmonë përballen me sfidën e informacionit të pjesshëm, qoftë për shkak të kufizimeve, përkufizimeve apo të metodologjive të ndryshme të studimeve.

Autori në këtë prezantim hedh dritë në rëndësinë e ndergjegjësimit të opinionit public bazuar në të dhëna nga studime serioze.

P.sh. një studim i hershëmsi ECA, konstaton se rreziku 1-vjeçar që i atribuohet populates së dhunshme të shoqëruar me sëmundje të rëndë mendore u gjet të ishte vetëm 4%, (që nënkupton se përafërsisht 96% e populates së marrë në studim do të vazhdojë të manifestojë dhunë).

Përveç shtjellimit të faktorëve që ndikojnë në dhunën në përgjithësi si përdorimi i alkoolit drogërave dhe aksesit në armët etj, autori në prezantimin e tij i kushton rëndësi rritjes së ndergjësimit të opinionit public dhe medias, duke e vënë theksin edhe në rëndësinë e mbrojtjes për të sëmurët me problem psikiatrike.

Fjalëkyçe: dhunë, ECA , rrezik, OBSH , popullatë, , studim, sëmundje psikiatrike , shëndet mendor avokim, alkool, drogë, armë.

Myths and the reality of “Psychiatric Violence”:

-Perceptions in the public opinion and the evolution of scientific opinion

Violence is defined by the World Health Organization as “...the intentional use of physical force or power, threatened or actual, against oneself, another person or against a group or community that either results in or has a high likelihood of resulting in injury, death, psychological harm, maldevelopment or deprivation...”(WHO 2018).

This wide encompassing definition of violence focuses on the health and wellbeing consequences of violence and less on the characteristics of violence as a social or cultural. Researchers are often eluded by the challenge of partial information due to various limitations, definitions or research methodologies. For example, an early ECA (Epidemiologic Catchment Areas Survey, Swanson JW, Holzer CE III, Ganju VK, et al, 1990, USA), affirm that it is important to note that the 1-year population-attributable risk of violence associated with serious mental illness alone was found to be only 4% , an estimated 96 per cent of people (violence that currently occurs) in the general population, would continue to manifest violent behaviors.

This presentation draws on rigorous studies and their results to shine the spotlight on the need to raise public awareness on “ psychiatric violence”. Aside from addressing typical factors related to violence such as the use of alcohol, drugs, access to firearms, the author highlights in particular the role of public and media opinion and the need to raise awareness with regards to the protection of mental health patients.

Key words Violence, ECA, risk, WHO, communities, study, mental health, mental disorder, advocacy ,protection,alcohol, drugs, arms.

14. NDËRLIDHJA NË MESË NIVELIT TË ANKTHIT, AGRESIVITETIT DHE ABUZIMIJT FIZIKË, SEXUAL DHE EMOCIONAL TEK PACIENTËT PSIKIATRIK NË QSHM – PRISHTINË

Behare Bojaxhiu, S. Rexhepi
Psikologe QSHM – Prishtinë

Ky studim synon të realizoj vlerësimin e komponentëve të veçantë të përfshirjes së nivelit të ankthit dhe agresionit tek pacientët psikiatrik me sëmundje kronike, të cilët marrin shërbimë në qendrën e shëndetit mendor në Prishtinë. Abuzimi fizikë është një faktor kyq që shfaqë problematika të llojeve të ndryshme, duke përfshir edhe ankthin dhe agresiviteti, prandaj është detyrë dhe synim që të hulumtohet kjo qështje.

Qëllimi: esencial i këtij studimi është që të kuptohet se çfarë përfshirje të ankthit dhe agresionit kemi tek pacientët psikiatrik nëse ushtrohet dhunë fizike, sexuelle dhe emocionale mbi ta.

Në këtë studim janë përdorur metodat deskriptive dhe korelative, ndërkaq për grumbullimin e të dhënave janë përdorur instrumentet matëse ku për ankth testi i Aeron Back i përbër nga gjithsej 21 ajtete, për matjen e shkallës së agresivitetit është përdorur testi Buss & Perry (1992), i cili përbëhet nga gjithësej 29 ajtete të cilët bëjnë matjen e agresionit në katër dimensione si: agresionin fizik, verbal, zemërimin dhe armiqësin me të tjerët. Për të kuptuar rrethë abuzimit kemi përdur testin të nxjer nga internet dhe të modifikuar nga ana e hulumtuesit, bënë matjen e abuzimit në tre dimesione, si abuzimin fizikë, sexual dhe emocional.

Popullata e cila ka qenë në fokus janë pacientët psikiatrik me sëmundje kronike të cilët marrin shërbime në qendrën e shëndetit mendor, ndërkaq mostra e zgjedhur përbëhej nga 60 subjekte, mostërzimi u realizua në mënyrë rastësore.

Nga rezultatet e fituara kemi kuptuar një shtrirje mesatare të nivelit të ankthit dhe agresionit tek pacientët psikiatrik me sëmundje kronike, por sa i përket pacientëve të cilët marrin shërbime përmes vizitave shtëpiake kanë treguar shkallë më të lartë të agresionit dhe nivelit të ankthit në krahasim me pacientët të cilët janë me qëndrim ditorë në qendër, femrat kanë treguar nivel më të lartë të ankthit dhe agresionit në krahasim me meshkujt. Sa i përket abuzimit rezultatet kanë treguar se pacientët psikiatrik dhe sëmundje kronike abuzohen më së shumti fizikisht dhe emocionalishtë, ndërkaq abuzim sexual kanë treguar një numer i vogël i femrave dhe aspak i meshkujve.

Correlation between anxiety level, physical, sexual and emotional abuse and Aggressiveness in patients with chronic psychiatric disorders

This study aims realization of the assessment of particular components of inclusion of the level of anxiety and aggression of psychiatric patients with chronic illnesses, who receive services at the Center for Mental Health in Pristina. Physical abuse is one of the key factors which displays problems of different sorts including also the anxiety and aggressiveness therefore a research of this issue it is both an obligation and goal.

Essential aim of this study is to understand what kind of involvement of anxiety and aggressiveness are manifested from psychiatric patients, if they are subjected to physical, sexual and emotional abuse. Second aim in the row but not in the relevance, is to understand if there exists a relation between the level of anxiety, aggression and physical abuse to psychiatric patients. Another aim is to understand if there is difference regarding demographic factors and also to understand differences between patients with daily residence in the center for mental health and the ones that receive services at their homes. In this study are used descriptive and correlative methods whereas for the collection of data are used measuring instruments - for anxiety the Aeron Back test composed of in total 21 items, for measuring the scale of aggressiveness is used Buss & Perry test (1992) composed of in total 29 items which conducts the measuring of aggression in four dimensions: physical aggression, verbal aggression, anger and hostility with others.

The population which was in focus are psychiatric patients with chronic illnesses who receive services at the Center for Mental Health in Pristina while the selected sample was composed of 70 subjects, the sample-selection was conducted by default.

From obtained results we understood an average dispersion of the level of anxiety and aggression of the psychiatric patients with chronic illnesses but as far as patients who receive services through home visits, they have showed higher level of aggressiveness and anxiety comparing to patients who are daily residing in the center, and females have expressed higher level of anxiety and aggression in comparison to males. Regarding the abuse, the results have shown that psychiatric patients with chronic illnesses are mostly abused physically and emotionally while sexual abuse was indicated in a smaller number involving females and none involving males.

Fjalët kyqe: Ankh, Agresion, Abuzim fizikë, sexual emocional, Pacientë psikiatrik,

15.DHUNA NDAJ PACIENTËVE ME SËMUNDJE TË RËNDË MENDORE

Pasho Maksuti

Psikiatër në Shërbimin Psikiatrik, QSUT “N. Tereza”-Tiranë

Qëllimi: Të hulumtohet dhuna që pësojnë personat me sëmundje të rëndë mendore për shkak të sëmundjes së tyre.

Metoda: Është bërë rishikimi i të dhënave mbi zotërimin dhe lidhjet e viktimizimit përmes dhunës, të personave me sëmundje të rëndë mendore. Është bërë vlerësimi në mënyrë kritike i literaturës dhe eksplorimi i qasjeve të mundshme për hulumtime në të ardhmen. Baza e të dhënave janë PubMed / MEDLINE dhe PsycINFO. Është bërë kërkimi duke përdorur disa terma që lidhen me sëmundjen e rëndë mendore me terma që përshkruajnë viktimizimin.

Rezultatet: Gjatë kërkimit janë identifikuar më shumë studime. Shumica e studimeve epidemiologjike tregojnë se pacientët me sëmundje të rëndë mendore kanë më shumë të ngjarë të jenë viktimat të dhunës se sa anëtarët e tjerë të komunitetit. Moshë e re, komorbiditeti me përdorimin e substancave dhe të qenët të pastrehë, janë faktorë rreziku për viktimizimin. Pacientët e viktimizuar kanë

Më shumë të ngjarë të përfshihen në sjellje të dhunshme sesa anëtarët e tjerë të komunitetit. Viktimizimi i dhunshëm i personave me sëmundje të rëndë mendore ka pasoja të pa favorshme afatgjata për rrjedhën e sëmundjes së tyre dhe dëmton më tej cilësinë e jetës së pacientëve dhe familjeve të tyre.

Përfundimi: Viktimizimi i personave me sëmundje të rëndë mendore është një problem serioz mjekësor dhe social. Parandalimi dhe administrimi i viktimizimit duhet të bëhet një pjesë e kujdesit rutinor klinik për pacientët me sëmundje të rëndë mendore.

Violence against patients with severe mental illness

Purpose: Investigate the violence suffered by people with severe mental illness as a result of their disease.

Method: Data on the prevalence and links of victimization through violence to persons with severe mental illness have been reviewed. Critical evaluations of the literature and exploration of possible approaches for future research were conducted. The databases to be used are PubMed / MEDLINE and PsycINFO. Research has been done using keywords associated with serious mental illness with keywords describing victimization.

Results: During the research, multiple relevant studies were identified. The majority of epidemiological studies indicate that patients with severe mental illness are more likely to be violently victimized than other community members. Young age, comorbid substance use, and homelessness are risk factors for victimization. Victimized patients are more likely to engage in violent behavior than other members of the community. Violent victimization of persons with severe mental illness has long-term adverse consequences for the course of their illness, and further impairs the quality of life of these patients and their families.

Conclusions: Victimization of persons with severe mental illness is a serious medical and social problem. Prevention and management of victimization should become a part of routine clinical care for patients with severe mental illness.

Referencat

1. Berzins KM, Petch A, Atkinson JM. Prevalence and experience of harassment of people with mental health problems living in the community. *Br J Psychiatry*. 2003;183:526–533.
2. Tsigebrhan R, Shibre T, Medhin G, Fekadu A, Hanlon C. Violence and violent victimization in people with severe mental illness in a rural low-income country setting: a comparative cross-sectional community study. *Schizophr Res*. 2014;152(1):275–282.

16. TRAJTIMI I DEPRESIONIT NËPËRMJET INTERNETIT Eksperienca në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor, Korçë

Elisaveta Dino

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Korçë

Hyrje: Depresioni është një problem i hasur shpesh dhe prek afërsisht 1 në 5 gra dhe 1 në 10 burra për gjatë jetës së tyre. Mes mënyrave tradicionale të trajtimit të këtij problemi, vitet e fundit po aplikohet dhe trajtimi i tij nëpërmjet internetit. “Unë luftoj depresionin” është një platformë program që ndodhet në internet dhe mund të përdoret nga të rriturit dhe adoleshenët që kanë forma të lehta ose të moderuara të depresionit. Prej dy vitesh vjen si risi në QKSHM Korçë, si një ndër tre qendrat e përzgjedhura në Shqipëri për të aplikuar këtë platformë të re si një mjet alternativë në trajtimin e depresionit.

Qëllimi: I këtij hulumtimi është të pasqyrojë eksperiencën e QKSHM Korçë për gjatë implementimit të kësaj platforme duke treguar ecurinë e këtij trajtimi, sfidat dhe risitë që sjell.

Metodologjia: Studimi është realizuar nga shqyrtimi i literaturës mbi këtë program si dhe nga mbledhja e të dhënave personale nga përdoruesit e platformës duke u bazuar tek ecuria e tyre në realizimin e hapave të këtij trajtimi. Janë angazhuar 8 profesionistë të qendrës (psikologë, mjekë,

punonjës social dhe infermier) për të mbledhur të dhënat nga eksperiencia e përdoruesve të këtij shërbimi.

Rezultatet: Nga individët të cilëve iu është sugjeruar trajtimi i depresionit nëpërmjet platformës online rreth 41% nuk kanë njohuri për përdorimin e internetit si formë trajtimi. Mbi 60 % e përdoruesve shfaqin angazhim të ulët për të realizuar seksionet ushtrimore në mënyrë individuale pa support profesionisti, si rezultat kjo dhe i humorit të tyre depresiv. Vështirësi në aplikim hasin individët bazuar dhe nga niveli i tyre social-kulturor apo dhe grupmosha, duke bërë që një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve të heqin dorë nga përfundimi i kësaj terapie. Rreth 68 % e përdoruesve të platformës banojnë në zona rurale dhe 32% prej tyre banojnë në zona urbane, gjinia femërore ze rreth 65 % të klientëve kundrejt 35 % që janë meshkujt. Rreth 20 % e përdoruesve kanë qënë rregullisht aktive dhe kanë përfunduar trajtimin.

Përfundimet: Kërkimi sugjeron se “Unë luftoj depresionin” është një platformë e mirëpritur nga të rinjtë e grupmoshave 20/30 vjeç si dhe më tepër tek individët që jetojnë në zonat urbane e kanë një nivel më të lartë social-kulturor. Kjo metodë trajtimi i pacimëte për rezultate positive tek përdoruesit e platformës që u ndoqën në vazhdimësi dhe nga një profesionist i shëndetit mendor përgjatë realizimit të sesioneve ushtrimore. Vështirësi në aplikimin e platformës u vu re më tepër tek individët nga zonat rurale si pasojë e një infrastrukture të mangët në përdorimin e internetit.

Treatment of depression via internet, the experience in the mental health community center of Korça

Introduction: Depression is a frequently encountered problem that affects approximately 1 in 5 women and 1 in 10 men throughout their lives. Among the traditional ways of dealing with this problem, during the last years it has also been applied its treatment via internet. “I Fight Depression” is an online platform program that can be used by adults and adolescents who suffer from mild or moderate forms of depression. Since two years, it has come as a novelty in the mental health community center of Korça, as one of the three centers selected in Albania to implement this new platform as an alternative tool in depression treatment. The purpose of this research is to reflect the experience of the mental health community center, of Korça during the implementation of this platform indicating the progress of this new treatment, the challenges and the innovations it induces.

Methodology: The study has been conducted by reviewing the literature on this platform as well as by collecting personal data from the users of this platform based on their progress in accomplishing the stages of this treatment. Eight professionals of the mental health center (psychologists, doctors, social workers and nurses) have been engaged to collect the personal data from the experience of the users of this service.

Results: 41% of the individuals who have been suggested to treat depression through the online platform do not have knowledge on using the internet as a form of treatment. Over 60% of the users show a low commitment to perform the exercise sections on their own without professional

support, even as a result of their depressive mood. Difficulties in using the online platform are encountered by individuals based on their socio-cultural level and /or age group, leading to a significant part of the program participants giving up on completing this therapy. About 68% of platform users reside in rural areas and 32% of them reside in urban areas, the female population accounts about 65% of the clients versus 35% males. Only 20% of users have been regularly active and have completed the treatment.

Conclusions: This study suggests that "I fight depression" is a platform mostly welcomed by young people of age group 20/30 years old as well as by individuals living in urban areas who have a higher socio-cultural level. This treatment had more positive results on the users that were consistently followed by a mental health professional throughout all the stages of the platform. Difficulties in applying this new treatment were mostly encountered in the rural areas due to a deficient infrastructure in the use of internet.

17. VLERËSIMI I SHËNDETIT MENDOR NË PROFESIONISTET E USHTRISË QË KANË SHËRBYER NË MISIIONE PAQERUAJTËSE JASHTË SHQIPËRISË

Mirela Gokaj, K. Idrizaj

Rezident i Psikiatrisë, Shërbimi i Psikiatrisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Tiranë

Qëllim: Identifikimi i simptomave dhe probabilitet i problemeve të shëndetit mendor në ushtarët profesionistë të cilët kanë shërbyer në misione paqeruajtëse jashtë kufijve të vendit.

Metodologjia: Studimi është i tipit deskriptiv. Në këtë studim janë përdorur dy instrumenta scl 90 dhe HTQ. Të dy instrumentet janë të validuar dhe standartizuar në gjuhën shqipe. Instrumentat u plotësuan nga individët nën kujdesin e psikologes së repartit dhe stafit të mesëm shëndetsorë. U vlerësuan profesionistët që kanë shërbyer për një periudhë 6 mujore në misione paqeruajtëse jashtë vendit të cilët kishin mbi 6 muaj që janë kthyer nga misionet.

Rezultatet: U përdor përpunimi i të dhënave sipas ssp 23. Nga përpunimi i të dhënave pjesa më e madhe e personave kishin ankesa somatike dhe simptoma të cilat kanë persistuar mbi 6 muaj pas kthimit në shtëpi. Kriteret diagnostike për Çrregullim të Stresit Post Traumatik nuk u përmbushën për shumicën e pjesëmarrësve. Mungesa e sigurisë për familjarët ishte shqetësimi më mbizotërues gjatë kohës kur ishin në shërbim.

Konkluzione: Niveli i njohurive dhe informacioni që kanë punonjësit profesionist të ushtrisë shqiptare në lidhje me pasojat e shërbimeve në misionet paqeruajtëse jashtë vendit mbi shëndetin mendor dhe atë fizik është shumë i ulët. Gjithashtu mbështetja e ulët nga institucionet që ata marrin rrit mundsiënë e përkeqësimit të situatës.

Kufizime: Studimi është realizuar në kushte kur këta punonjës shërbejnë akoma dhe shumë prej tyre kane shpreh shqetsimi se mos këto rezultate do të dëmtojnë ose të kenë ndikim negativ në vlerësimin e tyre të përgjithshëm.

Rekomandime: Rekomandohet suport psikosocial për punonjësit që shërbejnë në misione paqeruajtëse jashtë kufijve të vendit edhe të familjarëve të tyre.

Mental Health Assessment in Army Professionals Serving in Peacekeeping Missions Outside Albania.

Purpose: This study aims to identify symptoms and possibly mental health problems in professional soldiers who have served in peacekeeping missions outside the country's borders.

Methodology: The study is of descriptive type. Two instruments were used in this study HTQ and SCL90. Both instruments are validated and standardized in Albanian. The instruments were completed by individuals under the care of the ward of psychologist and secondary health staff. The inclusion criteria for evaluation were professionals who served for a 6-month period in peacekeeping missions abroad who had returned for more than 6 months .

Results: Data processing according was done with spss 23. Data most people had somatic complaints and symptoms that persisted for more than 6 months after returning home. The diagnostic criteria for Post Traumatic Stress Disorder were not met for the majority of participants. Lack of security for family members was the most prevalent concern while abroad.

Conlusions: The level of knowledge and information available to professional soldiers of the Albanian Army regarding the consequences of services in peacekeeping missions abroad on mental and physical health is very low. Also, low support from psychosocial instances increases the likelihood of the worsening of situation.

Limitations: The study was conducted under conditions when these employees are still serving and many expressed concern that these results would impair or have a negative impact on their overall rating.

Recommendations: Psychosocial support is recommended for staff and staffs family serving in peacekeeping missions outside the country.

18. SINDROMA NEUROLEPTIKE MALINJE - DIAGNOZA DHE MENEXHIMI NË URGJENCËN PSIKIATRIKE

Fatime Elezi

Shefe Urgjencës Psikiatrike, QSUT “Nënë Tereza”

Background: Sindroma neuroleptike malinje (NMS) është një situatë mjekësore, relativisht e rrallë, efekt anësor i paparashikueshëm, potencialisht kërcënuese për jetën e shkaktuar nga përdorimi i antipsikotikëve. Ky sindrom manifestohet me ndryshime të statusit mendor, temperaturë, rigiditet dhe disfunkcion të sistemit nervor autonom. Shkalla e mortalitetit së fundmi është më e ulët 0.02-3%.

Objektivi: njohja e incidencës, shkaqeve, faktorëve të riskut, patogenezës dhe e klinikës ndihmon mjekun në identifikimin, diagnostikimin e dhe ndërhyrjen e shpejtë përë trajtim adekuat. *Metoda:* rishikim i literaturës më të fundit, artikuj të marrë në PubMed, MEDLINE (2010-2019) një rishikim thelbësor mbi raportimet të një seri rastesh me NMS dhe të tjera informacione klinike dhe teorike të vlefshme për punën e një klinicisti.

Rezultatet: Neuroleptikët mund të shkaktojnë sindromën malinje, përfshirë edhe gjeneratën e re. Rritja e standarteve të kujdesit dhe njohja e plotë e NMS është përmirësuar sidomos në dekadat e fundit. Trajtimi specifik dhe simptomatik, si likidet intravenoze, antipiretikët dhe korigjimet e nevojshme për dehidratimin, disbalanca elektrolitike, monitorim i funksionit renal, kardiorespirator janë të indikueshme dhe të nevojshme.

Konkluzione: NMS është e rrallë por një çrregullim potencialisht fatal, ka variabilitet në mënyrën e fillimit dhe pacientët me këtë sindrom shpesh paraqiten në urgjenca të përgjithshme. Menaxhimi i pacientëve me NMS bazohet në ashpërsinë e tablosë klinike dhe të sigurisë diagnostike. Përdorimi i Dantrolenit dhe Amantadinës konsiderohen si trajtim i rëndësishëm në përmirësimin e rezultateve të mjekimit. Ndjekja e kujdeshme e pacientëve, ndërhyrja dhe trajtimi në kohë garaton ulje të vdekshmërisë.

Fjalë kyçe: sindroma neuroleptike malinje, etiopatogjeneza, parapitja klinike. trajtimi.

Neuroleptic Malignant Syndrome- its knowing and managing in Psychiatric Emergency Service

Background: Neuroleptic malignant syndrome is an uncommon and unexpected side effect of antipsychotic medications. This syndrome is a rare but potentially fatal complication for the life of patients. Clinical presentation is characterized by severe rigidity, tremor, fever, altered mental status, autonomic dysfunction, etc. The rate of mortality is 0.002-3% of patients taking neuroleptic drugs, including patients of both genders and all age groups.

Objective: In this presentation will present a review of neuroleptic malignant syndrome, its incidence and describes risk factors, clinical evaluation, diagnosis, complications, treatment,

prevention, and to provide information that will be useful in clinical settings, especially in emergency psychiatric unit.

Methods: review of recent literature (based on PUBMED and MEDLINE) was searched from 2010-2019 for key reviews, reports on series of cases of neuroleptic malignant syndrome, individual case reports, and other clinical and theoretical important information.

Results: all neuroleptics are capable of inducing the syndrome, including the newer atypical antipsychotics. The standard of care for the recognition of neuroleptic malignant syndrome has shifted considerably over the last years. Specific and symptomatic treatment, such as antipyretics, and intravenous fluids to correct dehydration and electrolyte abnormalities is necessary and widely supported.

Conclusions: Neuroleptic malignant syndrome (NMS) is a rare but potentially fatal disorder with a variable onset following neuroleptic treatment. Patients suffering from this syndrom often present to emergency departments for treatment, but neuroleptic malignant syndrome is widely variable both in presentation and patient outcomes. Dantrolene and Amantadine may also present an additional tool to improve long-term outcomes.

Key words: neuroleptic malignant syndrome, clinical presentations, etiopatogenesis, treatment.

19. DHUNA NDAJ PERSONAVE EPILEPTIKË SI PASOJË E STIGMËS

Pervin Vranica, S.Vranica, L.Vranica

Qendra diagnostike, International Health Center (IHC)

Qëllimi i punimit: është të prezentohet dukuria e dhunës si pasojë e stigmës tek personat epileptikë.

Metoda e punës: Janë përdorë të dhënat anamnestike dhe heteroanamnestike nga pacientët epileptikë dhe përcjellësit e tyre të paraqitur në Qendrën Shëndetësore Ndërkombëtare (International Health Center – IHC), në Prishtinë.

Diskutimi: Pacientët epileptikë shpeshherë ndihen të dhunuar si pasojë e stigmatizimit. Stigma nënkuptohet si vragë, marre, si dallim jo i preferueshëm dhe i dëshirueshëm, thujse janë persona në mënyrë jo të plotë normalë. Tek 90% të pacientëve me epilepsi lajmërohet ndjenja e dhunës si pasojë e stigmës. Egziston stigma *e jashtme*, publike apo aktuale dhe e *brendshme*, personale apo self-stigma. Kryesisht, kjo ndjenjë më shumë shprehet tek gjinia femërore, sidomos tek të pamartuarat në mesin rural, se tek ajo mashkullore.

Rezultatet: Sipas të dhënave tona, ndjenja e dhunës si pasojë e stigmës shprehet në përqindje tejet të lartë, pothuajse në 90% të rasteve. Ndjenja e dhunës si pasojë e Stigmës së jashtme, poashtu, ka vlera të larta, deri në 40% . .

Përfundimet: Qëndrimi dhe distanca ndaj të sëmurëve epileptikë është shprehje e marrëdhënieve të përgjithshme ndaj sëmundjeve dhe të të sëmurëve epileptikë me ndjenjën e dhunës si pasojë e stigmës, por jo marrëdhënie specifike ndaj kësaj popullate. Egziston prirja e shumë personave të kenë qëndrim refuzues ndaj çfarëdo çrregullimi apo sëmundjeje, pa marrë parasysh llojin e tyre!

Rekomandimet: Duhet të zbatohen programe të ndryshme publike shëndetësore në përmirësimin e qëndrimeve ndaj tyre, me qëllim të ndryshimit të qasjeve ndaj të sëmurëve të tillë në përgjithsi.

Violence against epileptic persons resulting from stigma

In this paper, the feeling of violence against epileptic persons resulting from stigma was presented. Many people have a tendenz to maintain a rejective approach towards any kind of disease. In this particular case, according to our results, this feeling has very high numerical values, up to 90% of the case. Our proposal has to do with the implementation of various pulic health programs for the improvement of the attitude towards them in general

Referencat

1. Lewis, JA. (1975). Violence and Epilepsy. JAMA 232 (11: 1165 – 7.
2. Marsh, L. et al. (2000). Aggression and Violence in Patients with Epilepsy. Epilepsy & Behavior 1(3): 160 – 8.

20. DHUNA SOCIALE NDAJ KONSUMUESVE TË MJETEVE NARKOTIKE

Pervin Vranica, S.Vranica, L.Vranica

Qendra diagnostike, International Health Center (IHC)

Qëllimi: është të paraqitet ndjenja e dhunës sociale ndaj konsumuesve të mjeteve narkotike.

Metoda e punës: është aplikuar intervista me konsumuesit e mjeteve narkotike të paraqitur në ambulancën IHC, në Prishtinë, në periudhën kohore prej 3 vjetëve, 2016 – 2018.

Rezultatet: intervista është bërë me 15 persona të tillë që kanë qenë të gjithë të gjinisë mashkullore. Edhe pse, në mesin tonë, ka edhe persona që konsumojnë mjete narkotike të gjinisë femërore, asnjëra nga to nuk është paraqitë. Pothujse, që të gjithë të intervistuarit kanë shprehë ndjenjën e dhunës së përjetuar nga mesi i tyre jetësor.

Diskutimi: Mesi shoqëror i yni ka një karakteristikë dhunuese ndaj konsumuesve të mjeteve narkotike, në formën e moskuptimit dhe mospranimit të tyre, duke i konsideruar të padenjë dhe të izoluar. Ky manifestim i tillë ndaj tyre, nga ana e mesit social, është dukshëm më intenziv dhe agresiv në krahasim me abuzimin e alkoolit dhe tymosjes!

Përfundimet: Në bazë të rezultateve tona, ndjenja e dhunës tek personat konsumues të mjeteve narkotike, është mjaft e shprehur. Kjo dukuri i “detyron” ata që të ndijnë nevojën e largimit të përkohshëm apo të përhershëm nga mesi i tyre shoqëror, duke u shoqëruar me bashkëmendimtarë, apo konsumues të tjerë të mjeteve narkotike, duke u përballur me sfidat e mëtutjeshme të konsumimit të mjeteve narkotike, gjë që i bënë edhe më të varur, me zvoglim të dëshirave dhe mundësive për nevojën e rehabilitimit eventual?

Rekomandimet: Në këtë kontekst, është më se e domosdoshme që personave të tillë dhe familjarëve të tyre, t’iu ofrohet ndihma e duhur shoqërore dhe ndihmat e natyrave të tjera, në përballimin dhe rehabilitimin përfundimtar të këtyre personave fatkeq [PubMed](#).

Social violence against consumers of narcotic substances

According to our results, the feeling of violence in consumers of narcotic substances is highly expressed. This phenomenon “obliges” them to feel the need temporary or permanent getaway from their society by associating themselves with people who think likewise, or other consumers of narcotic substances, by facing the ongoing challenges of the consumption of narcotic substances, which makes them even more addicted, which results in lower desires and means for the need of eventual rehabilitation.

Referencat

1. Appleby, L., et al. (1997). The impact of substance use screening on a public psychiatric inpatient population. *Psychiatric Services* 48: 1311 – 6. PubMed
2. Bacchus L., et al. (1999). Client perceptions of inpatient treatment: a qualitative account with implications for service delivery. *Drugs: Education, Prevention and Policy*. 6:87–97.

21. DHUNA DHE SËMUNDJET MENDORE

Halit Ibrahim

Klinika e Psikiatrisë së QKU - Prishtinë

Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë ndihmë në identifikimin, parashikimin dhe parandalimin e dhunës ndaj të sëmurëve mendorë, por edhe ndaj të tjerëve, kur ushtruesit e dhunës janë personat me sëmundje mendore. Metodologjia e përdorur është komparative dhe analitike.

Nga ky punim, i cili është bazuar në të dhëna të shumta të kësaj tematike, del se pacientët mendorë janë më së shumti të prirë që të jenë të dhunshëm nëse, përpos sëmundjes bazë psikiatrike, kanë edhe një diagnozë të dytë, atë të abuzimit me substanca edhe pse ka edhe faktorë të tjerë që kontribuojnë në këtë drejtim, sikur që janë historia e dhunës në të kaluarën, çrregullimet e personalitetit, moshë dhe gjinia, stresi, ekspozimi i hershëm ndaj dhunës, etj.

Personat me sëmundje mendore më shumë janë të prirë që të jenë viktimë, sesa ushtrues të dhunës dhe, përkundër faktit se ata janë më të prirë për dhunë sesa popullata e përgjithshme, ky dallim është shumë më i vogël sesa që mendohet dhe që mund të paraqitet në media.

A është Clozapine ilaçi më efikas për pacientët me prirje të dhunshme? Apo nevojitet një qasje e shumëfishtë, e cila vetëm si e tillë mund të japë rezultate?

Violence and mental illnesses

The purpose of this presentation is to provide assistance in identifying, predicting and preventing violence against the mentally ill, but also against others, when the perpetrators of violence are the mentally ill. The methodology used is comparative and analytical.

This presentation, which is based on extensive data on this topic, shows that mental patients are most likely to be violent if, in addition to the underlying psychiatric illness, they also have a second diagnosis, that of abuse of substances although there are other factors contributing to this, such as a history of past violence, personality disorders, age and gender, stress, early exposure to violence, etc.

People with mental illnesses are more likely to be victims than perpetrators of violence and, despite the fact that they are more prone to violence than the general population, this difference is much smaller than thought and can be presented in the media.

Is Clozapine the most effective medication for patients with violent tendencies? Or is there a need for a multiple approach that can only work as such?

Referencat

1. Violence and mental illness: what is the true story?
Mohit Varshney, Ananya Mahapatra, Vijay Krishnan, Rishab Gupta, Koushik Sinha Deb
2. Fazel S, et al. "Schizophrenia, Substance Abuse, and Violent Crime," *Journal of the American Medical Association* (May 20, 2009): Vol. 301, No. 19, pp. 2016–23.

22. MANIFESTIMET AGRESIVE - VIOLENTE TË PACIENTËVE TË CILËT TRAJTOHEN PËR NEVOJA TË GJYKATAVE NË IPFK

Gani Halilaj, F.Drevnja, Sh.Haxhibeqiri, S.Rexhepi, N.Fanaj, V.Haxhibeqiri, Q.Krasniqi, R. Drevinja

Qellimi: Paraqitja e rasteve të violencës te personat me çrregullime mendore, gjatë ekzaminimit psikiatrik–ekspertiza dhe atyre të cilët trajtohen sipas urdhëresës së gjykatave në IPFK. Trajtimi i këtyre personave, ballafaqimi me ekzaminim psikiatrik, shqiptimi I masës dhe trajtimi I detyruarame ndalim është mjaft sfidues. Në këto kondita pacientët shpeshëherë paraqesin riekzacerbime të sëmundjes dhe rrezikshmëri për vehten e tyre dhe personelin.

Metodologjia: Studimi është retro dhe anteroaktiv. Janë analizuar dosjet shëndësore të pacientëve, të rasteve të cilat kanë pas trajtim më të veqant, që kanë pasur manifestime agresive, rastet ku janë përdorur metoda shtërnguese-siguruese fizike e biologjike si masë parandaluese e rrezikshmerisë së tyre.

